



RELACION TEKNIK ARKITEKTONIKE

Objekti :

**Sistemimi dhe Rehabilitimi i Qendrës së Njesisë
Administrative Zall Bastar**

1. Të dhëna të përgjithshme dhe gjëndja ekzistuese eobjektit:

Vendodhja: Objekti i propozuar ndodhet në qendër të Njesisë Administrative Zall-Bastar.

Pershkrim: Sheshikanjësipërfaqerreth5100m², dheaktualishtështësheshnëmungesëtëplotëinfrastrukture. Rruga e cila kalon në këtë shesh thuajse nuk ekziston fare, ka mungesë të kanalizimit të ujërave të bardha, kanalizimit të ujërave të zeza, ndricimetj.

Ndërtesa e shtëpisë së kulturës është 1 kat me një sipërfaqe rreth 300 m² dhe lartësi 4.5 m dhe është në gjëndje tejet e amortizuar. Godina ndodhet në qendrën e fshatit. Në këtë shesh ndodhet dhe godina e Njesisë Administrative Zall Bastar, ajo e shkollës dhe disa objekte të tjera.

Në sheshin e këtij fshati ndodhet shkolla e 9-vjecare me një kapacitet prej 256 nxënësish, godina e Njesisë AdministrativeZall-Bastar,shtëpiaekulturës,ndodhen5objekteshumëfamiljare,menr.kati2ktddhedisashtëpi banimi private gjithashtu dhe biznese. Sheshi është i rrethuar në disa pjesë me mur me blloqe, në pjesë të tjera merrjeteteli, me kangjelladhenëdisapjesëiparrethuar. Fasadatetëgjithëobjekteveqërrethojnësheshinjanë të ndryshme dhe të unifikuara me njëratjetrën.



Figure 1 Gjendja Egzistuese e zones



Figure 2 Gjendja Egzistuese e objektit

2. Problematika dhe Propozimi

Vlerësimi fizik i objektit godina e shtëpisë së kulturës

- Mungon ngrohja
- Ka probleme me lagështirën e ambientit dhe katit të përdhë, terraces.
- Mungojnë dyer, dritare.
- Probleme me suvatimet e mureve brenda dhe jashtë godinës.
- Mungon rrjet elektrik.
- Mungon uji i pijshëm
- Njësjet Sanitare mungojnë në tërësi
- Muret e jashtme janë tejet të amortizuara

Objekti në tërësi për gjithëshe është jashtë funksionit. Për arsye të mëdha të kësaj lloje të dëmtimit, si dhe duke u konsultuar edhe me Komisionin Teknik të Bashkisë së Tiranës, propozojmë prishjen e tij dhe ndërtimin e një strukture metalike me mbulesë tipçati.



Figure 3



Figure 4



Figure 5



Figure 6

3-Propozimi i Qendrës

Ne kete zone propozohet nje rruge me dy kalime, si dhe nje hapsire parkimi me kapacitet 4 makina, e cila pozicionohet perpara Qendrës Shëndetësore. Në krah të saj eshte krijuar gjithashtu edhe nje xhep parkimi qe eshte i nevojshem per makinen e Ambulances.

Qendra kesaj zone pozicionohet ne zone nndermjetre objekteve kryesore: te Njesise Administrative, Qendres Shendetesore dhe strukturës së re të propozuar.

Hapësirat e reja të propozuara në qendër konistojnë në ishuj gjelbërimi dhe mobilie urbane në funksion të rivitalizimit te zones dhe sjelles se një fryme të re. Hapesirat e gjelbra krijojne module të kombinuara me stola duke alternuar materialet edrurit dhe betonit. Gjithashtu, qendra eshte mobiluar me elemente urbane sidrita dhe kosha mbeturinash dhe trotualet jane shtruar me pllaka.

Duke qene se objektet e banimit jane private eshte propozuar qe muret egzistues te vishen me pllaka guri, te pajisen mendericim dhe gjithashtu fasadat kryesore te objekteve doteshen me vate hendori, per ta unifikuar zonen.

Ne oborrin e shkolles eshte propozuar rregullimi dhe vijejimi i fushes se basketbollit per t’u perdorur sipas konceptit të shkollave te hapura për komunitetin.

PLANI I SISTEMIMIT

SHKALLA 1:500



Figure 7. Plani i Sistemimit

Perpara fillimit te projektimit te zones jane bera paraprakisht Rilevimi (azhornimi) i siperfaqes se zones.

Persa i perket azhornimit te rrjetit te infrastruktures sipas Formularit 3/1 eshte marre iformacion , per profilin e rruges dhe eshte reflektuar ne projekt.

- **Rrjeti rrugor**

Ne kete zone propozohet nje rruge me dy kalime,me gjeresi 7 metra si dhe nje hapsire parkimi me kapacitet 4 makina, e cila pozicionohet perpara Qendrës Shëndetësore. Në krah të saj eshte krijuar gjithashtu edhe nje xhep parkimi qe eshte i nevojshem per makinen e Ambulances.Pergjat rruges propozohen dhe trotuaret ne te cilat jane parashikuar dhe hidrantet e zjarrit.

- **Kanalizimet e Ujrave te zeza**

Per sa i perket kanalizimeve te ujrave te zeza , duke u konsultuar edhe me Keshillin teknik te Bashkise Tirane , u nxorr perfundimi qe rrjeti i kanalizimeve te ujrave te zeza te mos merret parasysh ne kete projekt.

- **Kanalizimet e Ujrave te bardha**

Meqenese në këtë zonë nuk ekziston rrjeti i kanalizimeve për ujërat e shiut,eshte parashikuar te zbatohet ne kete projekt.

- **Rrjeti i ndricimit Rrugor**

Rrjeti i ndricimit rrugor eshte parashikuar ne kete projekt. Ndricuesat jane parashikuar të tipit ”Led” duke llogaritur lartësinë dhe fuqinë në raport me gjerësinë e rrugës dhe hapësirat e sheshit.

- **Hapesira Urbane**

Perverc skemes se rrjetit rrugor (projektit të rrugës dhe trotuarëve), jane trajtuar te gjitha hapsirat e lira urbane, ku akomodohen funksione të tilla si ambiente clodhëse (me stola etj) për moshën e tretë dhe banorët e fshatit, sipërfaqe të gjelbërta ,ambjent lojrash per femije te cilat jane evidentuar dhe ne planin e pergjithshem.

- **Elementet e mobilimit urban**

Nje vemendje e vecante i eshte kushtuar edhe elementeve te mobilimit urban , te cilat jane perdorur ne kete zone ,te tilla si: stola, kosha të mbeturinave, vendin e vendosjes së konteinerëve dhe të largimit publik të mbeturinave, zgara apo rrethime të pemëve, kangjella kufizuese në trotuare si dhe bllokues të mjeteve në trotuare, zgarat për bicikletat, lodrat e femijeve etj.

Sipas sygjerimeve te mureve rrethues, dhe te veshjes se tyre eshte marre si reference Rehabilitimi i Sheshit “Qeha”, lloji i gurit, ndërtimi i murit si dhe ndricimi dekorativ.

- **Gjelberimi**

Hapësirat e reja të propozuara në qendër konistojnë në ishuj gjelbërimi dhe mobilie urbane në funksion të rivitalizimit të zones dhe sjelles së një fryme të re. Hapësirat e gjelbra krijojnë module të kombinuara me stola duke alternuar materialet e drurit dhe betonit. Gjithashtu, qendra është e mobiluar me elemente urbane si ndricues dhe kosha mbeturinash dhe trotualet janë shtruar me pllaka.

- **Rendera të zones së propozuar**



Figure 8. Imazh i zones së propozuar



Figure 9. Imazh i zones së propozuar

- Propozimi i Strukturës

Duke marrë parasysh vlerësimet nga Këshilli Teknik është propozuar që Shtëpia e Kulturës ekzistuese të prishe t dhe në gjurmët e ndërtesës së vjetër të ndërtohet një strukturë e re metalike me mbulesë tip çatidruri. Kjo strukturë e integruar me mobilimin urban të propozuar do të shërbejë si pjesë e rivitalizimit të zonës së qendrës duke shërbyer si një hapësirë në të cilën mund të zhvillohen aktivitete, takime, biseda apo panairë të vogla ku të mund të promovohen produkte të zonës.



Figure 10. Imazh i struktures se propozuar



Figure 11. Imazh i struktures se propozuar